



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 13337/2 prot

Fier, më 26.12.2024

V E N D I M

Nr. 150 Datë 23.12 2024.

**“Për miratimin e financimit të trajtimit ushqimor për sportistin e nivelit të lartë Julian Xhafa”**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 datë 27.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar , pika 9, 9, 16 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.789 datë 15.12.2021 “Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe trajtimin e sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerve të tyre” , i ndryshuar, në kërkesën e trajnerit protokolluar pranë Bashkisë Fier me nr.5355 prot. dt 15.05.2024 , shoqëruar me informacionin e dhënë nga Federata Shqiptare e Bilardos & Snooker, si dhe kërkesë së Sportistit Julian Xhafa , Këshilli i Bashkisë Fier ,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë financimin nga Bashkia Fier të trajtimit ushqimor për sportistin e nivelit të lartë Julian Xhafa , pjesë e ekipit të bilardos “Apollonia” Fier, fitues i vendit të parë në kampionatin Kombëtar për disiplinën me 9 gurë, për vitin kalendarik 2024, në masën 2 500 lekë ne dite,per 25 dite ne muaj.
2. Ky shpenzim do të përballohet nga zëri i shpenzimeve operative (602) të miratuar në Buxhetin e Bashkisë Fier.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit të Bashkisë Fier.
4. Ky vendim në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I KËSHILLIT**

**ANTONETA ÇUNAJ**

